

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NR. 43 REP.
NR. 14 KOL.



PULLE TARIFE



DËSHMI E TRASHËGIMISË LIGJORE

Në Tiranë, sot, më datë 06.01.2014 (gjashtë Janar dymijë e katërbëdhjetë), përpara meje Julian Zhelegu, Noter pranë Dhomës së Noterëve Tiranë, me Zyrë Noterie në adresën Rr. "Pjetër Bogdani", Nr. 13, Tiranë, u paraqit personalisht:

Kërkuesi: Znj. Davë Gjoka, shtetase shqiptare, e bija e Markut dhe Gjelës, lindur më 18.06.1944 në Simon, Mirditë dhe banuese në Njesinë Bashkiake Nr. 1, Rr. Mihal Grameno, P. 6, Shk. 1, Ap. 5, Tiranë, e ve, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr. 025078072 dhe Numër Personal E45618012L, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, bashkëshortja e trashëgimlënësit Frrok Gjoka, e cila, në bazë të Nenit 316 e vijues KC, ka paraqitur kërkesën e saj datë 30.12.2013 me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Frrok Ndue Gjoka.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, rezulton nga Certifikata e Vdekjes lëshuar nga ZGjC pranë Njesisë Bashkiake Nr. 1, Tiranë, se më datë 22.12.2013 ka vdekur i ndjeri Frrok Gjoka, shtetas shqiptar, i biri i Ndues dhe Dilës, lindur më 03.12.1943 në Peshqesh, Mirditë dhe banues në Njësine Bashkiake Nr. 1, Tiranë, i martuar, mbajtës i numrit personal E31203047T, vdekur në vendbanimin e tij në Tiranë.

Trashëgimlënësi Frrok Gjoka ka pasur vendbanimin e tij të fundit në Tiranë dhe sipas spjegimeve të kërkuesit pjesa më e madhe e pasurisë së tij ka qenë në Tiranë, e për pasojë, në përputhje me kërkesat e Nenit 348 KC, Nenit 53/1/a të Ligjit 7829/1994, të ndryshuar, Nenit 16 të Ligjit 7829/1994, të ndryshuar, dhe Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 2762/1, datë 10.04.2006, konstatohet se lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore është në kompetencën time vendore.

Pas paraqitjes së kërkesës përkatëse pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, në bazë të Nenit 53 të Ligjit 7829/1994, të ndryshuar, në lidhje me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nga ana e Dhomës Kombëtare të Noterisë është konfirmuar se trashëgimlënësi nuk ka disponuar me testament pasurinë e tij në kohën kur ka qenë gjallë dhe për të nuk është lëshuar një dëshmi trashëgimie ligjore.

Për sa më sipër, në bazë të Nenit 53 e vijues të Ligjit 7829/1994, të ndryshuar, dhe Nenit 316 e vijues KC, ka vend për të lëshuar dëshminë e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Frrok Gjoka.

Duke qenë se trashëgimlënësi ka vdekur më datë 22.12.2013, rrethi i trashëgimtarëve ligjorë të tij, do të rregullohet sipas përcaktimeve të Kodit Civil të vitit 1994 dhe nga Certifikata Familjare lëshuar nga ZGjC kompetente më datë 30.12.2013, provohet se trashëgimlënësi:

1. Ka qenë martuar me kërkuesen Znj. Davë Gjoka, me të dhënat e identifikimit si më sipër, gjallë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Nga verifikimi i certifikatës së martesës, trashëgimlënësi nuk ka pasur regjim të

ndryshëm pasuror nga ai i bashkësisë ligjore para dhe pas hyrjes në fuqi të Kodit të Familjes, pasi asnjë shënim përkatës nuk është bërë në certifikatën e martesës dhe/ose certifikatat e trungut e familjare.

2. Nga martesa me bashkëshorten e tij, trashëgimlënësi ka patur dy fëmijë:
 - a. *Z. Ardian Gjoka*, shtetas shqiptar, i biri i Frrokut dhe Davës, lindur më 02.04.1969 në Rrëshen, Mirditë dhe banues në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 1, Rr. Mihal Grameno 6, beqar, mbajtës i numrit personal G90402151Q, gjallë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit, dhe
 - b. *Znj. Valentina Gjoka*, shtetase shqiptare, e bija e Frrokut dhe Davës, lindur më 01.01.1973 në Rrëshen, Mirditë dhe banuese në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 7, Rr. Myslym Shyri 4, e martuar, mbajtëse e numrit personal H35101109O, gjallë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Nga verifikimi i rrethit të trashëgimtarëve si më sipër si dhe nga deklaratimet e kërkueses, rezultoi se nuk ka raste të padenjësishë dhe as heqjes dorë nga trashëgimia.

Gjithashtu nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë qenë lidhur në martesa të tjera dhe as të ketë pasur fëmijë nga martesa të tjera, jashtë martese dhe/ose fëmijë të birësuar.

Për sa më sipër dhe në përputhje me Nenin 361 KC, si trashëgimtarë të rradhës së parë të trashëgimlënësit do të thirren në trashëgim bashkëshortja dhe fëmijët e tij, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta nga 1/3 (një të tretën) pjesë të masës trashëgimore.

Në vijim të sa më sipër, çmohet se kërkesa e Kërkueses është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe në provat e administruara dhe si e tillë duhet pranuar dhe për këto arsye, në bazë të Nenit 348 KC,

VENDOSA:

- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin *Frrok Gjoka*, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të tij:
 - 1- *Davë Gjoka – Bashkëshortja;*
 - 2- *Ardian Gjoka – I Biri;*
 - 3- *Valentina Gjoka – E bija;*të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë nga 1/3 (një të tretën) pjesë të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme trashëgimore kudo ku ajo ndodhet dhe po në këto raporte përgjigjen për detyrimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi.
- Shpenzimet për lëshimin e kësaj dëshmie janë përballuar nga Kërkuesja.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.
- *Kjo Dëshmi Trashëgimle, sipas ligjit, hartohet në 1 (një) kopje origjinale. Kërkuesit dhe/ose çdo personi që justifikon një interes të ligjshëm, sipas kërkesës së tij/tyre, i/u lëshohet një ose disa kopje të dëshmisë së trashëgimisë, të njësuara me origjinalin.*

Nënshkruar e vulosur prej meje Noterit, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, në Tiranë, sot, më datë 06 Janar 2014.

NOTER
JULIAN ZHELEGU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 44 Rep.

Tiranë, më 06 Janar 2014

VERTETIM
NJESIA ME ORIGINALIN

Unë, Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterisë Tirane, vërtetoj se njësia bashkëlidhur është kopje e njëjtë me dokumentin original.

Dokumenti është *Deshmi e Trashëgimise Ligjore me nr. 43 Rep. e nr. 14 Kol., date 06.01.2014, leshuar nga une noteri e qe ruhet ne kete zyre noteriale.*

Dokumenti leshohet me kerkesen e Znj. Davë Gjoka, e njohur prej meje Noterit.

Vërtetimi i dokumentit u bë në bazë të nenit 56, të ligjit nr. 7859, date 01.06.1994 "Për Noterinë", (i ndryshuar) dhe pikave 3,4,7 të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.6291, date 17.08.2005.

PULLE TARIFE



NOTER
JULIAN ZHELEGU

A large, stylized handwritten signature in black ink, corresponding to the name Julian Zhelegu.